



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 04, datë 02.02.2018

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I BURIMIT TË RI GJENERUES TË ENERGJISË, HIDROCENTRALIT “MIRAKA”, NË PËRROIN E LUGJEVE DHE MIRAKËS”, BASHKIA LIBRAZHD, QARKU ELBASAN”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Kuarci Blace” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Miraka”, në përroin e Lugjeve dhe Mirakës”, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Kuarci Blace” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) miratimit nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë;
  - b) miratimit të procedurave për heqjen nga fondi pyjor;
  - c) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Librazhd.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDIRAMA**



**MINISTËR I LINJËS**  
**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**DAMIAN GJIKNURI**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**  
**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**LEDIA TOTA**

